A.K.P.A.
Nr 3138 Prot.
Datë,më 27.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE " HAMDI BUSHATI" SHKODËR

Nr.289 prot. Shkodër , më 25.11. 2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**
**DREJTORISË E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**
**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024 i ndryshuar, udhëzimi nr.4, dt 18.08.2025, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar

Shkolla e Mesme Profesionale "Hamdi Bushati" Shkodër ju njofton per krijimin e vendit të lire për pozicionin:

- Mësimdhënës të **teorisë** profesionale me kohë të pjesëshme dhe afat te caktuar,
  Drejtimi Tekstil-Konfeksion

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit
Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga

kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

**2. Dokumentet e aplikimit:**

a) letërmotivimin për pozicionin;
b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 tëkëtij udhëzimi;
c) kartën e identitetit;
d) diplomën;
e) librezën e punës;
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

**3**. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së,
brenda datës 09.12.2026

**DREJTOR I SHKOLLËS**
**MERITA ZENELI**

Adresa: Shkolla e Mesme Profesionale "Hamdi Bushati", e-mail:hamdibushati2@gmail.com. Rr.Hysen Lohja. Shkodër